



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



VLORA MARINA

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE

MARINA RESIDENCES VLORE SHPK

Nr. Prot. 1117/14 Vlorë, 14.05.2025

Nr. Prot. 489 Vlorë, 23.05.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

&

MARINA RESIDENCES VLORE SHPK

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, si institucion publik me statusin "Person Juridik Publik" përfaqësuar nga Prof. Dr. Aurela Saliaj në cilësinë e Rektorit si përfaqësuesi ligjor për çështjet akademike dhe protokollare dhe autoriteti më i lartë akademik,

&

Shoqëria Marina Residences Vlore Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në : Tirane Farke LUNDER në Lobby Home, Rruga Nacionale, Tirane - Elbasan, Tiranë, Shqipëri e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: M12103049U, përfaqësuar nga administratori Znj. Vanova Strakosha, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Administratorit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nisur nga interesi i përbashkët i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, dhe Shoqëria Marina Residences Vlore Sh.p.k si dhe në shërbim të interesit publik, duke konfirmuar angazhimin për të realizuar projekte që mbështesin studentët si faktor të rëndësishëm të zhvillimit, palët bien dakort të lidhin këtë marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "**Marrëveshja**")

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim, bashkëpunimin ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Marina Residences Vlore Sh.p.k si iniciativë për zhvillimin e arsimit dhe mbështetjes së studentëve, në kuadër të akordimit të bursave financiare nga Shoqëria Marina Residences Vlore Sh.p.k për studentët të cilët studiojnë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në nenin 3 të ligjit 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Mënyra e akordimit të bursave

1. Marrëveshja ka për qëllim akordimin e bursave nga ana e Marina Residences Vlore Sh.p.k për studentët e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë në vlerën prej 10.000 (dhjetë mijë) lekë në muaj/student. Shuma totale prej 120.000 (njëqind e njëzet mijë) lekë në vit/student.
2. Procedura e përzgjedhjes së studentëve që do të përfitojnë nga bursat e akorduara prej subjekteve të treta për studentët që ndjekin studimet në programet mësimore të Universitetit "Ismail Qemali", përcaktohet nga Universiteti.
3. Vendimi i Rektoratit Nr. 3, datë 28.01.2025 në të cilin është përcaktuar procedura e përzgjedhjes së studentëve përfitues do të jetë pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje.

Neni 4

Detyrimet e palëve

1. Universiteti detyrohet të ofrojë informacion dhe mbështetje për aplikantët, si dhe do të përzgjedhë studentët që do të përfitojnë bursën, sipas procedurave përcaktuara në aktet nënligjore të miratuara prej tij.
2. Universiteti detyrohet që bursat të shpërndahen dhe menaxhohen sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshjeje.
3. Marina Residences Vlore do të financojë dhe do të transferojë shumën e bursës së përcaktuar në llogarinë bankare të secilit student përfitues, sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshjeje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

4. Llogaria bankare e studentëve do të vihet në dispozicion të Shoqërisë Marina Residences Vlore nga Universiteti pas firmosjes së marrëveshjes së bashkëpunimit.
5. Marina Residences Vlore do të mund të përfshihet në aktivitete promovuese.

Neni 5

Procedura e ndjekur për studentët përfitues

1. Përfitues të kësaj marrëveshje do të jenë 3 (tre) studentë nga universiteti që ndjekin programet në çdo cikël studimi.
2. Procedura e përzgjedhjes së studentëve do të kryhet nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë në bazë të vendimit nr.3, datë 03.02.2025 "*Për procedurën e përzgjedhjes së studentëve bursistë, të financuar prej subjekteve të treta.*"
3. Tre studentët e përzgjedhur nga Universiteti do të përfitojnë bursën për 1 (një) vit kalendarik.
4. Emrat e studentëve të përzgjedhur do të shënohen në aneksin e kontratës që do të nënshkruhet nga palët pas finalizimit të kësaj marrëveshje.

Neni 5

Respektimi i marrëveshjes

Palët bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshesh të punës, motit të keq, "Fuqisë Madhore" ose shkaqeve të tjera objektive të cilat janë të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse palët nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.

Neni 6

Mirëbesimi

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe Marina Residences Vlore Sh.p.k do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të ruajnë dhe të administrojnë me mirëbesim të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 7

Afati i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje 1 (nje) vit nga data e nënshkrimit.
2. Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila Palë, nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara.

Neni 8

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes.
2. Kjo marrëveshje është hartuar në 2(dy) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga 1 (një) kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit Vlorë dhe në Fakultetet përkatës, 1 (një) kopje do të depozitohet në Shoqërinë Marina Residences Vlore Sh.p.k.

PËR
UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTOR
PROF. DR. AURELA SALIAJ



PËR
SHOQËRIA "MARINA RESIDENCES
VLORE"

ADMINISTATOR
Znj. VANOVA STRAKOSHA

